



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes

UNIVERSITETI “ HAXHI ZEKA”

dhe

**FEDERATËS SË BJESHKATARISË DHE NGJITJES SPORTIVE
TË KOSOVËS**



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

i lidhur ndërmjet palëve

1. **Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë**, të cilin e përfaqëson **Prof. Dr. Armand Krasniqi**, në cilësinë e Rektorit të këtij institucioni të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejme: **Universiteti**) dhe
2. **Federata e Bjeshkatarisë dhe Ngjitjes Sportive e Kosovës**, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson **Arianit Nikqi**, në cilësinë e përfaqësuesit/es ligjore të kësaj federate (në tekstin e mëtejme: **Federata FBNSK**)

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është krijimi i një kuadri për bashkëpunim ndërmjet palëve me synim përfshirjen aktive të studentëve të Universitetit në praktika profesionale, përvoja të drejtpërdrejta dhe angazhime në terren në fushën e turizmit malor, alpinizmit, sporteve në natyrë dhe aktiviteteve edukative që organizohen nga Federata FBNSK. Ky bashkëpunim synon gjithashtu të fuqizojë rrjetëzimin dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet studentëve dhe profesionistëve të fushës.

Neni 2

Baza Ligjore

Ky memorandum bazohet në tërësi mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe akteve përkatëse për organizatat joqeveritare dhe bashkëpunimin ndër-institucional.



Neni 3

Forma e Bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat vijuese:

- i. Përfshirja e studentëve në aktivitete praktike dhe angazhime në terren, të organizuara nga Federata FBNSK në bashkëpunim me Universitetin, në kuadër të ngjarjeve publike, aktiviteteve sportive dhe atyre në natyrë;
- ii. Krijimi i mundësive të përbashkëta për përvojë të drejtpërdrejtë në organizimin, menaxhimin dhe logjistikën e eventeve në turizmin malor dhe sportet në natyrë;
- iii. Mundësimi i rrjetëzimit dhe bashkëpunimit me profesionistë të sektorit të bjeshkatarisë, alpinizmit dhe organizatave të ngjashme;
- iv. Bashkëorganizimi i paneleve, trajnimeve, punëtorive dhe aktiviteteve edukative me pjesëmarrje të studentëve dhe stafit akademik;
- v. Njohja dhe certifikimi i kontributit të studentëve përmes certifikatave apo referencave profesionale nga Federata FBNSK, dhe mbështetje institucionale nga Universiteti për promovimin e këtyre përvojave;
- vi. Organizimi i praktikës së punës për studentë dhe/ose staf ndihmës, në koordinim të ndërsjellë dhe në përputhje me nevojat e të dyja palëve, me qëllim ngritjen e kapaciteteve.

Neni 4

Dispozitat Përfundimtare

Ky memorandum do të shërbejë si kuadër për marrëveshje të mëtejme specifike për aktivitetet dhe projektet konkrete të përbashkëta;

- ii. Memorandumi mund të ndryshohet ose plotësohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve;
- iii. Memorandumi nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplarë origjinalë, nga të cilët secila palë mban nga 2 (dy).



Neni 5

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe mbetet në fuqi deri në nënshkrimin e një marrëveshjeje tjetër që e zëvendëson atë, ose në rast të shfuqizimit me marrëveshje të ndërsjellë.

Në emër të **Universitetit "Haxhi Zeka"** dhe **Federatës së Beshkatarisë dhe Ngjitjes Sportive të Kosovës**, palët nënshkruese deklarojnë vullnetin për bashkëpunim të ndërsjellë në përmbushjen e këtij Memorandumi.

Në Pejë, më ____ / ____ / 2025

Rektor i Universitetit "Haxhi Zeka"

Prof. Dr. Armand Krasniqi

Kryetar i Federatës së Beshkatarisë dhe Ngjitjes Sportive të Kosovës

Arianit Nikqi

REKTORATI			
Nr. / Br. / No. 875		Nr. /faq / Br. str / No. pg 4	
Data / Datum / Date: 28/04/2025		Faqe / Page	